



# **BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS**

Mars 2021

# BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Mars 2021

## AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në edicionin e këtij buletini të përmuajshëm pasqyrohen aktivitetet për muajin mars 2021)

### Kryesuesi Maloku takoi Shefin e EULEX-it, Wigemark

Kryesuesi Maloku priti në takim Shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë EULEX-it, Lars-Gunnar Wigemark, me të cilin ka diskutuar tema të interesit të përbashkët.

Kryesuesi njoftoi Shefin e EULEX-it për punët dhe aktivitetet që janë duke u realizuar në sistemin prokurorial, me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit në Kosovë.



Shefi i EULEX-it uroi Kryesuesin për detyrën e re, duke thënë se institucioni që drejton do të vazhdojë mbështetjen e sistemit prokurorial në promovimin dhe forcimin e sundimit të ligjit.

Bashkëbiseduesit, thanë se sistemi prokurorial është duke punuar për realizimin e prioriteteve të veta për rritjen e efikasitetit, efektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies në këtë sistem, ndërsa EULEX-i përmes monitorimit, këshillimit dhe mënyrës së trajtimit të sfidave do të mbështesë sistemin prokurorial në realizimin e prioriteteve që ka.

## Mbahet takimi konstituiv i Komisionit për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative, i udhëhequr nga kryesuesi Armend Zenelaj, mbajti takimin e tij të parë konstituiv.



Rrjedhimisht, ky organ normativ i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka shqyrtuar një sërë prioriteteve, përfshirë realizimin e aktiviteteve përgjatë vitit 2020 dhe, në këtë kontekst, edhe objektivat e Planit të punës për vitin 2021, në përputhje me aktet e planifikuara të punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit.

Pjesëmarrësit e këtij takimi, theksuan se do të jenë të përkushtuar dhe të angazhuar maksimalisht për identifikimin dhe arritjen e objektivave institucionale për vitin 2021.

## Vlerësohet mbështetja holandeze për sistemin prokurorial

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku dhe Ambasadorja e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, Carin Lobbezoo, hapën sesionin e dytë të trajnimit me temën për menaxhimi aktiv, i cili u zhvillua në kuadër të Projektit holandez me titull: “Mbështetje për një sistem prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm në Kosovë”.

Me këtë rast, Kryesuesi Maloku falënderoi Ambasadorën Lobbezoo dhe përmes saj, edhe Mbretërinë e Holandës, për mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë dhe po jep për sistemin prokurorial të Kosovës.

Kryesuesi Maloku ofroi bashkëpunimin e tij dhe të krejt stafit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për iniciativat e bashkëpunimit që mund të zhvillohen në të ardhmen me Mbretërinë Holandeze.



Në anën tjetër, Ambasadorja Lobbezoo, tha se përmes mbështetjes holandeze synohet që sistemi prokurorial i Kosovës të fuqizohet me anë të trajnimeve, mësimëve dhe shkëmbimit të përvojave.

Në këtë trajnim morën pjesë kryeprokurorë, prokurorë dhe udhëheqës të administratës së prokurorive.

## Telegram ngushëllimi drejtuar familjes Krasniqi, me rastin e vdekjes së z. Enver Krasniqi, Prokuror i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

Në telegramin e ngushëllimit të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial, Jetish Maloku, me rastin e vdekjes së z. Enver Krasniqi, Prokuror i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, thuhet:

*E nderuara familje Krasniqi,*

*Me pikëllim të thellë morëm lajmin për vdekjen e familjarit tuaj dhe kolegut tonë të nderuar, Prokurorit të Shtetit, z. Enver Krasniqi.*

*Largimi i z. Enver Krasniqit nga kjo botë papritmas nuk është humbje vetëm për familjen Tuaj, por përgjithësisht edhe për sistemin e drejtësisë në vendin tonë.*

*Me këtë rast, më lejoni që në emrin tim personal dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës t’ju shpreh dhimbjen e madhe dhe ngushëllimet e mia më të sinqerta për Ju si familje, për të afërmit, kolegët dhe bashkëpunëtorët e Prokurorit Krasniqi.*

*Prokurori Enver Krasniqi ishte shembull i vlerave të larta njerëzore dhe ndershmerisë, i cili më përkushtim, dinjitet dhe profesionalizëm të lartë i shërbeu institucionit dhe vendit të tij.*

*I përjetshëm qoftë kujtimi për të!*

## Suspendohet nga detyra Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së

Këshilli Prokurorial i Kosovës, pas fillimit të procedurës penale ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit, Lavdim Krasniqi, me dyshimin për veprat penale: "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", "Ushtrim i ndikimit" dhe "Dhënie e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale", ka marrë vendim për suspendimin e të njëjtit me pagesë prej 50 për qind të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente. Po ashtu, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka marrë vendim për suspendimin e një zyrtareje të Sekretariatit, si e dyshuar për veprën penale "Moslajmërim i përgatitjes së veprave penale".

Ndërkaq, me qëllim të vazhdim të funksionimit të administratës së sistemit prokurorial në përgjithësi, KPK-ja caktoi Udhëheqësin e Zyrës Ligjore në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, Valdrin Krasniqi.

## Sistemi prokurorial lehtëson qasjen e avokatëve në objektet e prokurorive

Sistemi prokurorial i Republikës së Kosovës dhe Oda e Avokatëve të Kosovës arritën marrëveshje për lehtësimin e qasjes së avokatëve në objektet e prokurorive të Republikës së Kosovës.

Kjo marrëveshje është arritur pas takimeve të zhvilluara nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Jetish Maloku, me Kryetarin e Odës së Avokatëve të Kosovës, Behar Ejupi.



Lidhur me lehtësimin e qasjes së avokatëve në objektet e prokurorive është përgatitur një udhëzues, i cili parasheh lehtësimin e qasjes së avokatëve në objektet e prokurorive.

Kushtet dhe lehtësirat e krijuara për qasjen e avokatëve brenda objekteve të prokurorive të Kosovës janë në harmoni me aktet juridike, të cilat rregullojnë sigurimin, ruajtjen, qasjen, dhe rendin në objektet e sistemit prokurorial.

## Sistemi prokurorial organizoi ceremoni komemorative për Prokurorin Enver Krasniqi

Me rastin e vdekjes së Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Enver Krasniqi, është mbajtur ceremoni komemorative, e cila është organizuar nga sistemi prokurorial i Kosovës.

Në fillim të kësaj ceremonie, u lexuan telegramet e ngushëllimit të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku dhe Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi.

Më tej, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, para të pranishmëve të kësaj ceremonie, tha se Prokurori Enver Krasniqi ishte dhe mbetet shëmbëlltyrë e njeriut të ndershëm, i cili me dinjitet dhe profesionalizëm të lartë i shërbeu institucionit ku punoi.



Vajza e Prokurorit të ndjerë, Enver Krasniqi, Erina Krasniqi, në emër të familjes falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe vlerësimet e bëra për babanë e saj, duke thënë se kanë pasur shumë plane dhe ëndrra bashkë, por ndihet krenare që është rritur prej dy prindërish dhe një prindi, siç ishte ai.

## Kryesuesi Maloku u prit në takim nga Avokati i Popullit, Qelaj

Temë e diskutimit të këtij takimi ishte Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me ç'rast bashkëbiseduesit theksuan se ka avancuar më tutje aspektin e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve.





Në këtë takim u diskutua edhe për rolin që Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve ia jep Avokatit të Popullit, si dhe fakti se çfarë statusi ka Avokati i Popullit në procedurat e shkeljeve të pretenduara ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

### Vlerësohet mbështetja holandeze për fuqizimin e kapaciteteve profesionale të sistemit prokurorial

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Jetish Maloku, priti në takim Ambasadoren e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, Carin Lobbezo, ku mbështetja e vazhdueshme holandeze për sistemin prokurorial, me theks të veçantë në fuqizimin e kapaciteteve profesionale për prokurorët dhe stafin administrativ, ishte temë e diskutimit.

Kryesuesi Maloku, me këtë rast, tha se projekti holandez është duke e bërë një punë të madhe në fuqizimin e kapaciteteve profesionale në sistemin prokurorial. Ai tha se trajnimet, shkëmbimi i ideve dhe përvojave me ekspertë holandezë po ndikojnë në ngritjen profesionale dhe menaxhuese të stafit të këtij sistemi.



Të dy bashkëbiseduesit gjatë këtij takimi diskutuan dhe shkëmbyen ide për tema të tjera, të cilat ndërlidhen me luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

### Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel miratoi Raportin financiar për vitin 2020

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga kryesuesja Ariana Shajkocvi, në përbërjen e të cilit janë edhe prokurorja Bedrije Sylja-Alshiqi dhe prokurori Haki Geci, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin kanë marrë pjesë Ushtuesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, Valdrin Krasniqi dhe zyrtarë të tjerë të Sekretariatit.

Në fillim është shqyrtuar Raporti financiar i KPK-së për vitin 2020 dhe pas diskutimeve u miratua nga anëtarët e komisionit.



Temë tjetër e këtij takimi ishte edhe shqyrtimi i një kërkesë të Departamentit të Teknologjisë Informative lidhur me nivelizimin e shtesave të punonjësve të këtij departamenti.

Në fund u prezantuan dhe u diskutua për projektet kapitale të sistemit prokurorial për vitin 2021.

### Intensifikohet realizimi i aktiviteteve të përbashkëta të KPK-së me projektin britanik

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, së bashku me U.D. së Drejtorit të SKPK-së, Valdrin Krasniqi, priti në takim ekspertin e projektit britanik për fuqizimin e sistemit prokurorial në Kosovë, David Wells, me të cilin diskutoi për intensifikimin e aktiviteteve dhe prioritetet konkrete për realizimin e këtij projekti të rëndësishëm, i cili mbështet dhe ndihmon dukshëm fuqizimin e kapaciteteve të sistemit prokurorial të Kosovës.

Ai falënderoi ekspertin britanik për mbështetjen institucionale, duke thënë se mirëpret realizimin intensiv të aktiviteteve të përbashkëta, të cilat bëhen me qëllim të ngritjes së kapaciteteve administrative dhe profesionale të sistemit prokurorial të Kosovës.

Kurse, eksperti britanik, David Wells, pohoi se synimi i këtij projekti është arritja e efikasitetit në proceset e punës dhe rezultateve të nevojshme, të cilat dalin në kuadër të reformës së administratës së sistemit prokurorial dhe hartimit të akteve nënligjore.

## Telegram ngushëllimi, drejtuar familjes Fejza, me rastin e vdekjes së prokurorit të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, Ibrahim Fejza

Në telegramin e Kryesuesit të Këshillit Prokurorial, Jetish Maloku, thuhet:

*E nderuara Familje Fejza,*

*Me dhimbje dhe pikëllim të thellë morëm lajmin e papritur për ndarjen nga jeta të familjarit tuaj dhe kolegut tonë të dashur, Ibrahim Fejza.*

*Me këtë rast, e nderuara familje, na lejoni të ndajmë dhimbjen me Ju, duke shprehur ngushëllimet tona më të sinçerta për Ju, të afërmit, pastaj kolegët dhe bashkëpunëtorët e tij.*



*Prokurori i ndjerë, Ibrahim Fejza, do të mbetet përherë në kujtimet tona si shembull i dinjitet, përkushtimit dhe integritetit njerëzor dhe profesional në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës.*

*Qoftë i përjetshëm kujtimi për të!*

## Miratohet Plani vjetor i punës së Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive i KPK-së, nën udhëheqjen e prokurorit Veton Shabani, kryesues, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë prokurorja Sevdije Morina, anëtare dhe Valon Jupa, drejtor i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së

Prokurorisë, me ç'rast u shqyrtua drafti final i Planit të punës për vitin 2021, draft ky, që u miratua nga anëtarët e këtij komisioni dhe përmban objektiva që janë në përputhje me planet e punës dhe aktet e tjera strategjike të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit, me qëllim të krijimit të një planifikimi sa më të qëndrueshëm të administrimit të prokurorive të vendit.



Tutje, takimi vazhdoi me vlerësimin e pikave të tjera të rendit të ditës lidhur me kalimin nga regjistrat fizikë në elektronikë të SMIL-it dhe ngarkesën me lëndë të prokurorive, duke u bazuar në numrin e prokurorëve dhe në të dhënat e vitit 2020, si dhe shkallën e efikasitetit të punës në këtë periudhë të pandemisë Covid-19.

## Miratohen Raporti vjetor (2020) dhe Plani i punës (2021) së Këshillit Prokurorial të Kosovës

Raporti vjetor për vitin 2020 dhe Plani i punës për vitin 2021 të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ishin aktet e para që u miratuan në takimin e KPK-së, me ç'rast ky i fundit u miratua me disa rekomandime të anëtarëve të KPK-së.

Rrjedhimisht, u tha se këto akte pasqyrojnë aspekte të veçanta të punës njëvjeçare të Këshillit dhe arritjet e tij, si dhe synimet dhe planifikimet vijuese për këtë vit, të cilat janë në përputhje me aktet strategjike të sistemit prokurorial.



Po në këtë takim, Këshilli mori vendime për hapjen e konkurseve për avancim të prokurorëve në prokuroritë,

si në vijim: katër prokurorë në Prokurorinë e Apelit, dy prokurorë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe një në Prokurorinë Themelore të Prishtinës.

Po ashtu, pas skadimit të mandatit të anëtarëve paraprakë të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, me kërkesë të kësaj të fundit, Këshilli Prokurorial ka caktuar anëtarët e rinj nga radhët e sistemit prokurorial me mandat katërvjeçar në këtë përbërje: Xhevdet Bislimi, Kryeprokuror i Prokurorisë së Apelit, Dulina Hamiti nga Prokuroria Themelore e Prishtinës dhe Valdrin Krasniqi nga Sekretariati i KPK-së.

Gjatë këtij takimi është konfirmuar lista e kandidatëve për kryeprokuror të Prokurorisë Themelore në Gjakovë në përbërje: Dëshirë Jusaj dhe Ramiz Buzhala, si dhe është themeluar paneli hetimor për rastin e një prokurori të Prokurorisë Themelore të Gjilanit.

Këshilli miratoi edhe Planin e personelit administrativ për vitin 2021 të sistemit prokurorial, kurse në përfundim të takimit mbajti një seancë dëgjimore për rastin disiplinor të një prokurori të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, vendimi i së cilës do të bëhet publik siç përcaktohet me ligj.

## Zëvendëskryesuesi i KPK-së takoi Kryeprokurorin e Ferizajt

Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, njëherësh Kryesues i Komisionit për Administrim të Prokurorive, Veton Shabani, i shoqëruar nga zëvendësmentaxheri i Projektit TIK-SMIL, Nexhat Haziri, ka mbajtur një takim pune me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Shukri Jashari.



Temë e diskutimit ishte largimi i regjistrave manualë në kuadër të digjitalizimit të procesit të punës, me ç'rast faza e pilotimit të këtij projekti do të zbatohet fillimisht në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, duke pasur parasysh se ka qenë prokuroria e parë e vlerësuar si ndër më të suksesshmet në implementimin e SMIL-it dhe pastaj do të zgjerohet edhe në të gjitha prokuroritë e tjera të vendit.

Ky aktivitet do të fillojë me regjistrat RLN dhe PPN më 3 maj 2021 dhe do të vazhdojë me regjistrat e tjerë.

Gjatë diskutimeve të zhvilluara, u tha se pasi të ketë përfunduar procesi i pilotimit, në bashkëpunim me Komisionin për Administrim të Prokurorive do të përgatitet raporti dhe plani i zgjerimit të largimit të regjistrave fizikë nëpër prokurori dhe të njëjtat dokumente së bashku me rekomandime do të dërgohen për miratim në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

## Regjistrat manualë, temë diskutimi e Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2022-2024

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KPK-së, nën udhëheqjen e Ariana Shajkovcit, kryesuese, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin anëtarët aprovan Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për periudhën trevjeçare 2022-2024.

Në këtë kontekst dhe në kuadër të angazhimeve të ardhshme për zbatimin e kësaj kornize është diskutuar edhe mundësia e plotësimit të nevojës për prokurorë dhe personel administrativ, me qëllim të krijimit të shanseve për një zhvillim të qëndrueshëm të procesit të punës profesionale dhe administrative në sistemin prokurorial të vendit.



Tutje, ky takim, vazhdoi me diskutimin e një sërë projektsh kapitale dhe implikimet e tyre buxhetore.



## Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Rrjedhimisht, në muajin mars ka pasur aktivitete të ndryshme në kuadër të Sekretariatit të KPK-së, si vijojnë:

Ka vazhduar ofrimi i informatave shtesë lidhur me disa nga indikatorët e pyetësorit CEPEJ, që kanë të bëjnë me sistemin prokurorial dhe përgatitja e Raportit të zbatimit të planit të punës së Këshillit 2020, si dhe janë zhvilluar një sërë aktivitete në kuadër të Grupit për inspektimin e zbatimit të masave mbrojtëse nga Covid 19.

Në bashkëpunim me CILC-in është organizuar trajnimi për menaxhimin aktiv dhe është zhvilluar një takim me ekspertin e projektit holandez, CILC, me ç'rast është diskutuar për punët e realizuara dhe ato që pritet të realizohen në kuadër të këtij projekti.

Po ashtu janë koordinuar kërkesat për qasje në dokumente zyrtare dhe është hartuar shkresa për Zyrën e Presidentes për dekretimin e pesë prokurorëve me mandat të përhershëm dhe janë ofruar informatat e kërkuar nga Këshilli i Evropës lidhur me buxhetin e Këshillit dhe të dhëna statistikore për vitin 2020, që do të përfshihen në pyetësorin e projektit KOSEJ.

Ka filluar përgatitja e Raportit për Nënkomitetin për Drejtësi, Liri dhe Siguri, që do të mbahet në qershor 2021 dhe është mbajtur një takim koordinues me zyrtarët për komunikim të prokurorëve, ku është diskutuar për komunikimin e brendshëm dhe jashtëm dhe për Strategjinë për komunikim të sistemit prokurorial 2021-2023.

Gjithashtu janë ofruar informatat e kërkuara nga ambasadat e huaja lidhur me trajtimin e rasteve të shpëlarjes së parasë për vitet 2019 dhe 2020 dhe është kthyer një përgjigje në pyetjet e dërguara nga Kallxo.com lidhur me zbatimin e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe është dërguar një përgjigje në kërkesën e Institutit të Kosovës për Drejtësi, e cila ka të bëjë me statistikën disiplinore për prokurorë sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në kuadër të burime njerëzore, prokurimit dhe administratës janë realizuar trajnimet e stafit

sipas planit të trajnimeve dhe janë mbështetur auditorët e jashtëm, kurse në kuadër të sektorit për buxhet, financa dhe shërbime të përgjithshme është realizuar takimi i Komisionit, ku është aprovuar Raporti vjetor financiar për vitin 2020, si dhe ka filluar përgatitja e Kërkesës për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2022-2024 dhe është përgatitur Pyetësori i vetëvlerësimit për vitin 2020 sipas instruksioneve dhe afateve të përcaktuara.

Nga fusha e teknologjisë informative është përgatitur Pyetësori vetëvlerësues për menaxhimin financiar dhe kontrollin për fushën e TI-së në sistemin prokurorial dhe është mbajtur trajnimi i stafit të Prokurorisë Themelore Mitrovicë për përdorimin e SMIL-it, përfshirë edhe shkëmbimin elektronik të të dhënave me gjykatë.

Gjithashtu me kërkesë të Ambasadës Amerikane dhe në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore të Gjakovës është përgatitur dokumenti me specifikat teknike të Dhomës për të Mitur dhe është publikuar versioni i ri i raporteve statistikore në sistemin elektronik për menaxhimin e rasteve në ZMNV dhe është prezantuar Moduli i Vlerësimit në Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Dosjeve të Prokurorëve.

Në bashkëpunim me stafin e prokurorëve është përgatitur dokumenti për avancimin e shkëmbimit elektronik të të dhënave në mes të prokurorisë dhe gjykatave dhe është prezantuar drafti i Udhëzuesit për menaxhimin e procesit të punës përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve në Prokurorinë e Shtetit.

Po ashtu është përgatitur Raporti i punës së projektit TIK/SMIL për periudhën nëntor 2020 - shkurt 2021 dhe është bërë publikimi i versionit të ri të sistemin elektronik për menaxhimin e rasteve në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, ku janë vendosur raportet e përgjithshme të punës së stafit sipas regjioneve.

Janë përgatitur raporte krahasuese mbi ngarkesën me detyra për përdoruesit në prokurori të ndryshme të profilit referentë regjistruar dhe është përgatitur plani kohor për largimin nga puna e regjistrave fizikë/manualë



për të gjitha prokuroritë themelore dhe Prokurorinë Speciale.

## Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara në mars nga ana e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë ishte hartimi i raporteve analitike për numrin e nevojshëm të prokurorëve në sistemin prokurorial, mbështetjen e procesit të transferimeve dhe avancimeve të prokurorëve, si dhe procesit të emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Gjakovës, në mbështetjen e komisioneve të Këshillit Prokurorial përmes angazhimit të drejtpërdrejtë dhe përmes ofrimit të informatave të nevojshme, në përditësimin e të dhënave në dosjet e prokurorëve dhe mbështetjen e procesit të zhvillimit të bazës së të dhënave për prokurorë - SEMDP.

Nga aplikacioni *kriMKorr* janë gjeneruar të dhënat statistikore për veprat penale karakteristike nga Mekanizmi përcjellës dhe është përpiluar Raporti për muajin mars dhe janë grumbulluar të dhëna statistikore për punën e prokurorëve, të cilët iu kanë nënshtruar procesit të vlerësimit të performancës.

Zyra për Statistika ka grumbulluar të dhëna nga prokurorët dhe ka përpiluar pasqyra për ngarkesën dhe efikasitetin e prokurorëve në zgjidhjen e lëndëve nga regjistrat: PP, PPM, PPN, PPP dhe NJN, për secilin prokuror veç e veç. Po ashtu, kjo Zyrë ka grumbulluar të dhëna statistikore për gjendjen e rasteve nga secila prokurori sipas regjistrave: PP, PPM, PPN, PPP dhe NJN dhe sipas departamenteve, si dhe ka përpiluar raporte për muajin mars. Kjo zyrë ka përgatitur edhe të dhëna të tjera statistikore sipas kërkesave të parashtuara nga Zyra për Komunikim Publik e KPK-së dhe ka përpiluar shkresa njoftuese, përmes të cilave prokurorët dhe prokuroritë janë njoftuar për afatet e raportimit të të dhënave statistikore, me qëllim të përpilimit të Raportit për tremujorin e parë të vitit 2021 dhe janë përgatitur format, tabelat dhe linqet për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave.

Aktivitetet e Zyrës për Trajnime kanë vazhduar me Programin për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë, me ç'rast përmes platformës Zoom është realizuar trajnimi i specializuar për mashtrimin dhe korrupsionin në prokurimin publik, qëllimi i të cilit ishte avancimi i njohurive për prokurimin publik dhe zbatimin e drejtë të dispozitave për hetimin dhe gjykimin e veprave penale të kësaj natyre. Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e prokurorive themelore, prokurorët e Prokurorisë Speciale dhe gjyqtarët e gjykatave themelore, gjyqtarët e Departamentit Special dhe zyrtarët hetues policorë.

FAO në bashkëpunim me ekspertët e angazhuar në kuadër të këtij programi dhe në mbështetje të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural organizoi trajnimin për ngritje të kapaciteteve për përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, që janë përgjegjëse dhe të ndërlidhura në zbatimin e legjislacionit në fushën e sektorit të pylltarisë. Qëllimi i trajnimit ishte zbatimi i programit për mbështetje në fuqizimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumëqëllimor të pyjeve për të përmirësuar jetesën në vendet rurale dhe për të adresuar ndryshimin klimatik në Kosovë. Ky program ka për qëllim që të rrisë kontributin e sektorit pyjor në ekonominë kombëtare përmes mundësisë së menaxhimit gjithëpërfshirës dhe shumëqëllimor të pyjeve dhe që fuqizohet në përputhje me rregullat përkatëse dhe mbështetet me zinxhirë vlerash të përgjegjshëm ndaj çështjes gjinore dhe ndryshimeve klimatike. Ky program është strukturuar rreth tre komponentëve, ku secili prej tyre është funksionalizuar më tej në rezultate dhe aktivitete të caktuara. Komponenti i parë i përket përmirësimit të shfrytëzimit të ligjshëm, tregtimit të drurit dhe zbatimit të ligjit në sektorin e pylltarisë. Objektivat e këtij komponenti synojnë, ndër të tjera, edhe përmirësimin e kapaciteteve të shërbimeve publike për të lehtësuar zbatimin e ligjit me shkathtësi dhe pajisje të reja dhe për të siguruar mbështetjen e publikut të gjerë në luftimin e aktiviteteve ilegale në sektorin pyjor. Përfituesit e këtij trajnimeve ishin prokurorët e gjashtë prokurorive themelore të Kosovës, prokurorët e ngarkuar me lëndët e ndërlidhura me sektorin e

pylltarisë apo shfrytëzimin e resurseve natyrore  
në kundërshtim me ligjin.